

Haxhi (Mehmet) Gogaj

(3.06.1973, shqiptar nga Deçani/Deçane, hotelier, pjesëtar i UÇK-së)

Haxhiu me vëllain Ardeshirin aderuan në UÇK në muajin prill të vitit 1998. Prindërit e tyre me familjarë, e kanë braktisur Deçanin/Deçane dhe u strehuan në Lubëniq/Ljubëniç. Në datën **25.05.1998**, situata në Lubëniq/Ljubëniç ishte e tensionuar për shkak të sulmit mbi policinë serbe nga ana e UÇK-së. Atë ditë, Haxhiu dhe Ardeshiri kanë shkuar në **Lubëniq/Ljubëniç**, për ta nxjerr familjen nga fshati. Në çastin kur dolën nga shtëpia e familjes Huskaj, ku ishte strehuar familja e tyre, policët serb që ishin duke parakaluar pranë, hapën zjarr drejt tyre. Haxhiu u qëllua për vdekje, ndërsa Ardeshiri shpëtoi nga plumbat. Haxhiun e kanë varrosur në oborrin e xhamisë në Deçan/Deçane. Më vonë, e kanë riarrosur në varrezat lokale.

Burimet: deklarata M.G, FDH-15841; deklarata NN, FDH-12104; deklarata N, FDH-12116; deklarata NN, FDH-12095; deklarata K, FDH-12101; deklarata A.Ž, FDH-12089; AI, *Ljubenic and Poklek...*, 3-5, FDH-36828; HRW, *Po naredenju...*, 414.

Hysen (Daut) Alimehaj

(23.03.1959, shqiptar nga Lubëniq/Ljubëniç, komuna e Pjesë/Peç, zdrukthëtar, katër fëmijë)

Kur dëgjuan se forcat serbe kishin filluar depërtimin në **Lubëniq/Ljubëniç** [**25.05.1998**], Hyseni me bashkëshorten Monën dhe fëmijët menjëherë shkuan të kushëriri Bajram Alimehaj dhe atje u strehuan në bodrumin e tij. Rreth orës 14:30, një fqinje i ka njoftuar se forcat serbe i kishin vrarë burrat e familjes Hamzaj [të shikohet regjistrimi në faqen 256]. Kjo e shtyu Hysenin që t'i çonte djemtë e vet, Zyferin dhe Dautin, në pyllin e afërt. Mendonte të kthehej në bodrum pasi t'i siguronte të bijtë. Pas disa orësh, në bodrum erdhi Vesel Alimehaj i moshëthyer që ta merrte një batanije, për ta mbështjell trupin e pajetë të Hysenit. Në këtë mënyrë, Mona dhe të bijat mësuan për vrasjen e Hysenit. E kishin qëlluar me armë zjarri. Banorët e çuan trupin e tij në shtëpi dhe, pastaj, në xhami. Ditën e nesërme, Hysenin e kanë varrosur

në varrezat e fshatit, së bashku me të gjithë burrat e tjerë që pësuan po atë ditë. Pas zhvarrosjes, në muajin tetor të vitit 1999, mbetjet mortore të Hysenit u riarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Lubëniq/Ljubëniç.

Burimet: deklarata M.A, FDH-15843; deklarata S.H, FDH-36664; AI, *Ljubenic and Poklek...*, 3-5, FDH-36828; HRW, *Po naredenju...*, 414.

Mehmet (Ukë) Ukshinaj

(13.04.1926, shqiptar nga Lubëniq/Ljubëniç, komuna e Pejës/Peç, hidraulik, gjashtë fëmijë)

Mehmeti me bashkëshorten Belqizarën kanë mbetur në shtëpinë e vet, pranë rrugës magjistrale Pejë/Peç – Deçan/Deçane, pas sulmit të forcave serbe [25.05.1998] ndaj **Lubëniqit/Ljubëniç**. Pas tri ditësh [**28.05.1998**], Belqizarja ka shkuar që t'i bashkohej pjesës tjetër të familjes, e cila ishte strehuar te vëllai i Mehmetit, në fshatin Kodrali/Kodralija. Trupin e pajetë të Mehmetit e ka gjetur i vëllai Qerimi. Kufoma ishte e karbonizuar dha pa kokë. Koka ishte e varur në një peme në oborr. Qerimi e ka varrosur Mehmetin në oborr. Në datën 15.11.1998, familjaret i kanë riarrosur mbetjet mortore të Mehmetit në varrezat e fshatit. Pas përfundimit të luftës, më 22.10.1999, trupi i Mehmetit u zhvarros me trupat e burrave të tjerë të vrarë në Lubëniq/Ljubëniç. Një ditë më vonë, familjarët e kanë riarrosur Mehmetin në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Lubëniq/Ljubëniç.

Burimet: deklarata E.U, FDH-15835; HRW, *Po naredenju...*, 414; *Bodies of Three Women Found Together with Animal Carcasses in Llausha*, pasqyra e lajmeve, KIC, 31.10.1998, FDH-29784; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 154, FDH-23857.

Halit (Zeqë) Krasniqi

(11.03.1948, shqiptar nga Vranoci/Vranovac, komuna e Pejës/Peç, bujk, pesë fëmijë)

Herët në mëngjes, më **29.05.1998**, forcat serbe kanë hyrë në fshatin **Vranoc/Vranovac**. Banorët e braktisën menjëherë fshatin. Haliti e ka çuar bashkëshorten Xufen dhe fëmijët te farefisi në fshatin fqinj të Lum-